



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1002/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Euro Miti” shpk, me NUI, me seli ne Fshatin Muhoc Komuna Ferizaj, ndaj debitorit “Kosova Turizëm” shpk me NUI me seli ne rr.” Ahmet Kaçiku nr.35 ne Ferizaj, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1421/22 dt.19.05.2023, me datën 10.11.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit “Kosova Turizëm” shpk me NUI ... me seli ne rr.” Ahmet Kaçiku nr.35 ne Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1421/22 dt.19.05.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1421/22 dt.19.05.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “Kosova Turizëm” shpk me NUI ... me seli ne rr.” Ahmet Kaçiku nr.35 ne Ferizaj, i ushtruar ndaj urdhrit përmbartimor P.nr.289/21 dt.20.05.2021, i lejuar nga përmbartuesi privat Besnik Aliu, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj ndërsa ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.289/21 dt.20.05.2023 te Përmbartuesit Privat.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe prapësimi i debitorit te aprovet ose aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit ka ushtruar kreditori me arsyetimin se nuk qëndrojnë arsyet e debitorit, propozon qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar aneksen e debitori dhe ta vërtetoj aktvendimin atakuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Euro Miti” shpk, me NUI ..., me seli ne Fshatin Muhoc Komuna Ferizaj, me datën 20.05.2021, ka paraqitur propozim për përmbirim ndaj debitorit “Kosova Turizëm” shpk me NUI80163878 me seli ne rr.” Ahmet Kaçiku nr.35 ne Ferizaj, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave me nr.08042019002 dt.08.04.2019, 08042019001 dt.28.04.2019, 01092019001 dt.01.09.2019, 20092019003 dt.20.09.2019. Përmbaruesi Privat Besnik Aliu nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbirimor P.nr.289/2021 dt.20.05.2021, ka lejuar përmbirimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga faturat t’i paguaj shumën prej 1,755.20 euro si dhe shpenzimet tjera te procedurës.

Kundër urdhrin përmbirimor debitori, me datën 28.05.2021 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se faturat e lëshuara nga kreditori asnjëherë nuk janë pranuar nga debitori, nënshkrimi dhe fatura e theksuar nuk është nënshkrimi i debitorit, faturat nuk janë te vulosura dhe nuk dihet kush i ka firmosur, debitori asnjëherë nuk ka pranuar sasi te furnizimeve te cekura si ne faturat e shënuara ne këtë urdhër përmbirimor, propozon qe gjykata ta anuloj urdhrin përmbirimor dhe ta detyroj kreditorin ti paguaj shpenzimet e procedurës

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 04.06.2021 ka ushtruar kreditori, me pretendimin se asnjë nga kushtet për anulimin e urdhri përmbirimor nuk ekzistojnë pasi është nxjerr konform dispozitave te LPP dhe se faturat i plotësojnë te gjitha tiparet e dokumentit te besueshëm ashtu siç është paraparë me nenin 29 par.1.3 te LPP, përmbaruesi përmbirimin e cakton sipas faturave si dokumente te besueshme e jo sipas fletë dërgesave, propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta refuzoj prapësimin e debitorit si te pabazuar dhe ta vërtetoj urdhrin përmbirimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1421/22 dt.19.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbirimor, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se faturat janë dokumente te besueshme sipas te cilave mund te caktohet përmbirimi për realizim te kërkesës konform nenit 29 par.1 dhe par.3 te LPP dhe i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 37 i LPP. Te njëjtat janë dorëzuar ne origjinal, mbajnë nënshkrimin e debitorit si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë. Gjykata pretendimet e debitorit i ka analizuar por ka gjetur se te njëjtat nuk mund te jenë objekt shqyrtimi ne këtë procedurë andaj edhe nuk vlerësohen ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit te rigorozitetit formal ne bazë te cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera,

andaj edhe bazuar ne nenin 71 dhe ne kuptim te nenit 73 te LPP edhe ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e ceshtjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dyte, vlereson se gjykata e shkalles se pare i ka zbatuar drejte dispozitat e Ligjit te Procedures Permbarimore kur e ka refuzuar si te pabazuar prapesimin e debitorit dhe ka lene ne fuqi urdhrin permbarimor.

Gjykata e shkalles se dyte, vlereson se gjykata e shkalles se pare ne baze te provave te cilat i ka pasur ne dispozicion ne shkresat e lendes, ka dhene aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj perfundimin juridik te gjykatës se shkalles se pare, lidhur me kete ceshtje e pranon edhe gjykata e shkalles se dyte, me cka mbi bazen e ketyre rrethanave dhe fakteve kesaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkalles se pare është i drejte dhe i bazuar. Konsideron se faturat nr.08042019002 dt.08.04.2019, 08042019001 dt.28.04.2019, 01092019001 dt.01.09.2019, 20092019003 dt.20.09.2019 mbi bazen e te cilave është lejuar permbarimi plotësojnë kushtet ligjore per te qene dokumente te besueshme konform nenit 29 par.3 te LPP i cili percakton se *“Dokumenti i besueshem është i pershtatshem per permbarim po qe se ne te është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e permbushjes se detyrimit monetar“*. Neni 37 te LPP-se thote se *“kur propozimi per permbarim paraqitet ne baze te dokumentit te besueshem, mjafton qe propozimit ti bashkengjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vertetuar sipas ligjit”*.

Bazuar ne dispozitat e lartcekura dhe gjendja faktike e vertetuar ne kete rast rezulton se keto fatura si te tilla jane te pershtatshme per permbarim, sepse jane te nenshkruara nga debitori, te vulosura nga ana e tij si edhe propozimit per permbarim i jane bashkangjitur ne origjinal, dhe ne kete menyre konsiderohet se jane pranuar ne menyre te rregullt nga i njëti epo te njëten kohe jane edhe te pershtatshme per tu ekzekutuar. Sa i perket pretendimit te debitorit se gjykata e shkalles se pare ka bere konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, kjo gjykatë vlereson se ky pretendim nuk qendron sepse debitori me asnjë provë nuk e ka argumentuar pretendimin e tij ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP. Gjykata e shkalles se dyte analizoi edhe pretendimet tjera te debitorit por vlerësoi se te njëtat jane të pabazuara dhe jo relevante per një vendosje ndryshe prandaj edhe te njëtat i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e gjykatës se shkalles se pare e vertetoi.

Marrë parasysh parimin e rigorozitetit formal, ne proceduren permbarimore behet realizimi direkt i mbrojtjes juridike te konstatuar ne dokumentin permbarimor i cili permban aktin juridik me te cilin vertetohet ekzistimi i kerkeses dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit permbarues qe sipas propozimit te kreditorit te caktoj dhe zbatoj permbarimin.

Kompetenca e Dhomes se Shkalles se Dytë per te vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet ne dispoziten e nenit 3 paragrafi 2 te LPP-se, me te cilen është paraparë se ne shkallen e dyte vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II.nr.1002/23, datë 10.11.2023

Gjyqtari,
Dren Rogova